

UNMIK/REG/2008/20
21 prill 2008

RREGULLORE NR. 2008/20

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË NDRYSHUAR TË UNMIK-ut
NR. 2001/19 MBI DEGËN E EKZEKUTIVIT TË INSTITUCIONEVE TË
PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) 1244 (1999) të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) Nr. 1999/1, të datës 25 korrik 1999 mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke vepruar në pajtim me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Pas shpalljes së Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi themelimin e Degës së Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Pas konsultimit me Qeverinë e Kosovës,

Me qëllim të ndërprerjes së funksioneve të tre (3) anëtarëve ndërkombëtarë në Komisionin për Emërime të Larta Publike (KELP),

Me anë të kësaj shpall:

Neni 1
Ndryshim

- 1.1 Fshihet paragrafi I (ii) (e) i Shtojcës 1 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/19 lidhur me emërimin e anëtarëve ndërkombëtarë në KELP.
- 1.2 Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut nr. 2001/19 shfuqizon tërë legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me Komisionin për Emërime të Larta Publike, i cili nuk është në harmoni me të.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 korrik 2008.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm